



UNIVERSITETI I EJL  
ЈНЕ УНИВЕРЗИТЕТ  
SEE UNIVERSITY

**Univerziteti i Evropes Juglindore**  
**Shkup**  
***Fakulteti i Administratës Publike***

**Punim seminarik**

**Lënda: *Sociologjia Politike***

**Tema : *”Antiglobalizimi”***

**Punoi : *Isa Avdullai***

**Mentor : *Ali Pajaziti***

**Shkup, 2009**

***Përmbajtja :***



<i>Hyrje</i> ... ..	3
<i>Përkufizimi i Antiglobalizimi</i> ... ..	4
<i>Lëvizjet Anti-globaliste</i> ... ..	5
<i>Ideologjia e Lëvizjes Antiglobaliste</i> ... ..	7
<i>Përfundim</i> ... ..	9
<i>Literatura</i> ... ..	10

## *Hyrje*

Para se të filloj që të shkruaj për Antiglobalizimin, do të kisha dashur që të shfrytëzoj dhe në pika të shkurta të shkruaj disa fjalë për globalizimin si nocion, që në vazhdim të kemi pasqyrë të qartë se kundër (anti) çkahit në të vërtetë janë antiglobalistat.

Globalizimi është term kuptimi i të cilit nuk është i qartë aq sa duhet, prandaj edhe ekzistojnë dallime të mëdha mes autorëve reth përkufizimit të tij.

Disa Globalizimin e shohin si një process i cili çon drejt bashkimit të njerëzve, shteteve dhe kulturave të ndryshme, si një proces i cili synon ta shëndrojë botën në një “ fshat global “, fshat të vogël ku të gjithë do të jetonin në marëdhënie shumë të mira ndërshtetërore.

Nëqoftëse do të kishte ekzistuar një kuptim i vetëm për globalizimin, atëherë ai do të ishte “integrim në nivel botëror”.<sup>1</sup>

Autorët tjerë, globalizimin e shohin si proces që mundëson lidhjen e njerëzve nga mbarë bota dhe krijimin e përfitimeve për të gjithë, ndërsa disa të tjerë që janë më tepër antiglobalizimit, atë e shohin si proces që individëve dhe shteteve të pasura ju mundëson që të pasurohen edhe më tepër në kurizin e të varfërve.

Pra, që të kemi fitues gjdoherë duhet të ketë edhe humbës. Pjesa e dytë, e humbësve në suaza të globalizimit gjdoher është më e madhe dhe ndoshta mu prej këtu edhe lindin kritikën negative në adresë të globalizimit, kritikë kjo që në literaturë të ndryshme do ta hasim si “antiglobalizim” apo ndokund edhe si “lëvizje antiglobaliste”.

Në pjesën e parë të këtij punimi, do bëhet një paraqitje teorike e dukurisë së Antiglobalizimit apo Lëvizjeve antiglobaliste si nocion, që po mundohen t’i qëndrojnë përballë procesit të globalizimit, kurse në vazhdim do të përqëndrohemi dhe shtjellojmë mënyrën e organizimit dhe veprimet të tyre si dhe aspektet e ndryshme ku edhe është më i zëshëm antiglobalizimi si proces.

---

<sup>1</sup> Etem Aziri – “Sociologjia”, f. 425

*“Është thënë se të kundërshtosh Globalizimin është sikurse të kundërshtosh kundër ligjit të gravitacionit”  
Kofi Anan <sup>2</sup>*

## ***Përkufizimi i Antiglobalizimit***

Anti-globalizimi është qëndrim politik i opozitës, për të perceptuar aspektet negative të globalizimit. Lëvizja përkatëse është e njohur gjerësisht si lëvizje e anti-globalizimit dhe është kryesisht një përpjekje bazë, me mbështetje nga disa elitat intelektuale.

Antiglobalizmi është nocion që më së shpeshti përdoret për të shënuar lëvizjet, ideologjitë ose politikat shtetërore, të cilat në këtë ose në atë mënyrë kundërshtojnë proceset e globalizimit, fuqinë politike të korporatave shumëkombëshe dhe pushtetin e ushtruar përmes kontratave tregtare.<sup>3</sup>

Termi “antiglobalizim”, është një term që më shumë e preferojnë mediat. Kjo mund të çojë në disa ngatërime, sepse aktivistët i kundërshtojnë vetëm disa aspekte apo forma të globalizimit, e jo edhe vetë globalizimin.

Vetë aktivistët, për shembull Noam Chomsky, kanë thënë se ky emër është i pakuptimtë, ngase qëllimi i kësaj lëvizjeje është globalizimi i drejtësisë (shtrirja e drejtësisë sociale në mbarë globin), “lëvizja për drejtësi globale” është një emër i përbashkët për ta. Shumë aktivistë ndërkaq bashkohen nën sloganin “një botë tjetër është e mundur”<sup>4</sup>

Aktivistët e antiglobalizimit protestojnë kundër marrëveshjeve të tregtisë globale, efektetve negative të tregtisë së lirë për vendet e varfra dhe ndotjen e mjedisit jetësor, gjegjësisht ata protestojnë kundër efekteve negative të globalizimit.

Në fakt, shumë prej njerëzve të përfshirë në lëvizjet antiglobaliste nuk janë kunder një bote pa kufij dhe mbështesin lidhjet e ngushta ndërmjet popujve dhe kulturave të ndryshme të botës. Pjesa më e madhe e tyre janë pro-globalizmit.

Anti-globalistët mendojnë se nganjëherë janë të marginalizuar nga mediat kryesore dhe qeveritë e tyre për shkak të shikimeve të forta "anti-biznes", shumica e

---

<sup>2</sup> [http://thinkexist.com/quotation/it\\_has\\_been\\_said\\_that\\_arguing\\_against/151768.html](http://thinkexist.com/quotation/it_has_been_said_that_arguing_against/151768.html)

<sup>3</sup> Ali Pajaziti - Fjalor

<sup>4</sup> Mr. Rejhan Neziri – “Globalizimi”

mediave nëpër botë janë në pronësi të të pasurve apo korporatave të mëdha, për të cilët aktivistët besojnë se kanë konflikt të interesave me pjesën tjetër të shoqërisë.

### *Lëvizjet Anti-globaliste*

Edhe pse mbështetësit e lëvizjes shpesh punojnë së bashku, lëvizja është heterogjene dhe përfshin ndryshime, nganjëherë të kundërta, mirëkuptim të procesit të globalizimit, vizione alternative, strategji dhe taktika të ndryshme.

Aktivistët e kësaj lëvizje parapëlqejnë që ti përdorin termat positive si “global justice” (drejtësi globale), ose “fair-trade movement” (lëvizje për tregti të lirë), Global Justice and Solidarity Movement (Gj&SM), (Drejtësi Globale dhe Lëvizje Solidaritetit), apo thjesht Movement (Lëvizja), dhe përdorimin parulla të tilla si “Global Justice” (drejtësi globale) dhe “globalize liberation”(liberalizim global).

Disa fraksione të lëvizjes kundërshtojnë globalizimit si të tillë, por shumica dërrmuese e pjesëmarrësve reshtohen bashkë me Lëvizjet e Popujve Indigjen, Organizatat Joqeveritare Për të Drejtat e Njeriut, “lëvizjet e gjelbërta”, si edhe me lëvizjet politike jo-kapitaliste si ato të socializmit, anarhizmit, dhe komunizmit.

Antiglobalistët nuk kundërshtojnë kapitalizmin apo tregjet ndërkombëtare si të tilla, por kundërshtojnë ato pasi që ky lloj kapitalizëm pretendon të jetë jo-transparent, ata kundërshtojnë kapitalizmin e sodit pasi që në të ka shumë mekanizma jodemokratike.

Ato janë veçanërisht kundërshtues të "abuzimit globalizimit" (neoliberalizmit), dhe institucioneve ndërkombëtare që janë krijuar për të nxitur neoliberalizmin pa marrë parasysh standardet etike, institucionet si World Bank (WB)<sup>5</sup>, International Monetary Fund (IMF)<sup>6</sup>, Organization for Economic Co-Operation and Development (OECD)<sup>7</sup>, World Trade Organization (WTO)<sup>8</sup>, dhe të traktateve të "tregtisë së lirë" siq është North American Free Trade Agreement (NAFTA)<sup>9</sup>.

Aktivistët gjithashtu kundërshtojnë forumet tregtare si World Economic Forum (WEF)<sup>10</sup>, dhe Azia Pacific Economic Forum (APEC)<sup>11</sup>, si dhe qeveritë të cilat promovojnë të tilla marrëveshje apo institucione.

---

<sup>5</sup> Banka Botërore

<sup>6</sup> Fondi Monetar Ndërkombëtar

<sup>7</sup> Organizata Ekonomike për Zhvillim dhe Bashkëpunim

<sup>8</sup> Organizata Tregtare Botërore

<sup>9</sup> Marrëveshja për Tregti të lirë e Amerikës së Veriut

<sup>10</sup> Forumit Ekonomik Botëror

<sup>11</sup> Forumi Ekonomik Azis dhe Pacifikut

## Isa Avdullai – “Antiglobalizimi”

Ata gjithashtu potencojnë se, në qoftë se kufijtë janë të hapur për qarkullim të lirë të mallërave, ato duhet të jenë të hapura edhe për të lejuar qarkullimin e lirë dhe ligjor të njerëzve dhe zgjedhjen e qëndrimit për emigrantët dhe refugjatët.

Levizja Antiglobaliste është mjaft e gjërë, duke përfshirë grupet e kishës, grupe çlirimtare, parti të majta, parti nacionaliste, ambientaliste, bashkimet fshatare, grupe antiracizëm, anarkiste, e tjerë. Sidoqoftë shumica janë reformatore, të cilët luftojnë për një formë më humane të kapitalizmit. Disa të tjerë janë më revolucionare duke besuar tek një sistem më human sesa tek kapitalizmi.

Protestat e lëvizjes për drejtësi globale i kanë detyruar takimet e larta (samitet) ndërkombëtare të mbahen larg qyteteve të mëdha ku mbaheshin zakonisht, në lokacione të vetmuara ku protestat janë të pamundshme.

Si organizata më të njohura antiglobaliste janë Fifty Years is Enough, International Forum on Globalization, ATTAC, Global Exchange, Globalise Resistance, Ruckus Society, Ya Basta (sipas thënies së njëjtë zapatiste që do të thotë “Mjaft më!), Indymedia (Independent Media Center), Black Bloc, Food not Bombs (FNB), Friends of Earth, Public Citizen etj.<sup>12</sup>

---

<sup>12</sup> Ali Pajaziti - Fjalor

## *Ideologjia e Lëvizjes Antiglobaliste*

Janë të shumta aspektet ku kundërshtohet globalizimi. Antiglobalistët i arsyetojnë qëndrimet e veta në aspektet vijuese. Duke filluar këtu nga problemet ekonomike, dimenzioni shoqëror, ai politik, si dhe problemet e mjedisit.

Nëse analizohen me vëmendje do të vërejmë se të gjitha këto dimensione janë të lidhura ngusht njëra me tjetrën. Kështu, vetëm për të përmendur disa shembuj, problemet e mjedisit nuk mund të trajtohen si të izoluaras nga dimensionet e "ekonomisë" dhe as nga ai i "politikës".

Është bërë e qartë se globalizimi po krijon pabarazi edhe më të mëdha në mes shteteve të botës dhe bota është bërë bipolare, gjegjësisht botë e vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim.

Në përgjithësi, kritikët shprehen se rezultatet e këtij procesi nuk janë ato që ishin parashikuar kur u synua rritja e tregtisë së lirë dhe për më tepër se shumë institucione të përfshira në sistemin e globalizimit nuk kanë marrë në konsideratë interesin e vendeve të varfëra e të klasës punëtore si dhe qështjet e mjedisit. Teoricientët e tyre, mbështetur në argumente ekonomike, deklarojnë se tregëtia e lirë e pakufizuar krijon përfitime për të pasurit në kurriz të të varfërve.

Antiglobalistët preferojnë ta shohin globalizimin jo si një fenomen që sjell përfitime për të gjithë por si një fenomen të inicuar dhe kontrolluar nga vendet e zhvilluara kapitaliste dhe korporatat transnacionale.

Institucionet Kryesore (Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Organizata Tregtare Botërore) dhe korporatat transnacionale nuk e promovojnë zhvillimin ashtu siç thonë. Ato sipas antiglobalistëve paraqesin një "kolonializim të ri", përmes dhënies së huave shteteve të Botës së Tretë, me kusht që të zbatojnë politikën në përputhshmëri me interesat e elitave të shteteve të Botës së Parë.<sup>13</sup>

Shumë konferenca të mbajtura nga ministrat e tregtisë dhe të financave të vendeve që e përbëjnë thelbin e kombeve të globalizimit zhvillohen nën protesta të mëdha, herë-herë të dhunshme, nga kundërshtarët e "globalizimit të korporatave".

---

<sup>13</sup> Këtu bëhet fjalë për një ndarje që ka mbetur që nga koha e Luftës së Ftohtë kur SHBA-ja dhe aleatët e ture e llogaritin veten si shtete më të zhvilluara, pra si Botë e Parë, BRSS-ja dhe aleatët e tyre, pra shtetet komuniste logariteshin si shtetet e Botës së Dytë, ndërsa shtetet tjera të pazhvilluara llogariteshin si Botë e Tretë.  
Etem Aziri – "Sociologjia", f. 442

## Isa Avdullai – “Antiglobalizimi”

Korporatave transnacionale të cilat llogariten si forca kryesore lëvizëse e globalizimit ekonomik u mundësohet që të bëjnë eksploatimin e burimeve natyrore të Botës së Tretë dhe të pasurohen në kurizin e tyre.

Antiglobalistët mbrojnë tezën se politikat që po zhvillon Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe korporatat transnacionale janë shkaktare për problemet globale, si ngrohja e atmosferës së tokës, vrima e ozonit, apo shpyllëzimi i pyjeve tropikale.

Një aspekt tjetër që kunërshtohet nga antiglobalistët është dimensionin shoqëror. Padyshim se bota po shëndërrohet në një "global village". Përveç komuniteteve tradicionale si familja apo fqinjësia, po dalin në skenë komunitete të reja komunikimi (chat, e-mail, facebook), por ato nuk zëvendësojnë dot këto hapësira tradicionale komunikimi.

Nëse do kalonim pastaj në dimensionin kulturor të globalizimit, ata thonë se si rezultat i afrimit të kulturave të ndryshme, vjen deri te shkatërimi dhe zhdukja e disa kulturave. Këtu vlen të përmendet zhdukja e kulturave Indijane, si dhe ajo e Majëve dhe Actekëve, kultura këto të cilët edhe pse ishin të mëdhaja, nën ndikimin e kulturës Amerikane dhe Meksikane pothuajse janë zhdukur plotësisht. Kur jemi te kultura duhet të përmendnim edhe shembullin e Hollywood-it, ku prej një qendre lansohen prodhime të cilat mund të shihen në të gjithë botën e kësaj nuk duhet mohuar një lloj "amerikanizimi" i kulturës.

E njëjta gjë po ndodh edhe me gjuhën. Kohëve të fundit vërehet shfrytëzimi çdo ditë e më i madh i gjuhës Angleze si në komunikim zyrtar ashtu edhe në komunikimin e përditshëm nëpërmjet futjes së fjalëve angleze në formë të internacionalizmave.

Si element i kulturës duhet shqyrtuar edhe aspektet fetare. Kohëve të fundit rezistenca më e madhe ndaj globalizimit vjen nga shtetet lindore ortodokse. Kjo ndodh pasi që vet procesi i globalizimit çon në humbjen e rolit të kishës në udhëheqjen e politikës shtetërore.

Por duket se një nga dimensionet ku antiglobalistët janë edhe më të zëshëm, është dhe ai i politikës. Ata kundërshtojnë ideologjinë e "globalizimit liberal" SHBA-të pasi që dolën më të fortë nga Lufta e Ftohtë, ato i kanë dhënë të drejtë vetes që kinse me qëllim të mbrojtjes të të drejtave të njeriut, ushtarakisht të intervenojnë nëpër vende të ndryshme të botës.

Në këtë këndvështrim antiglobalistët e konsiderojnë globalizimin si një formë tjetër të "amerikanizimit", dhe i logarisin SHBA-të si një " polic botëror". Secili shtet që merr guximin t'i rezistojë atij, si Afganistani, Iraku, Siria, Libani, Egjipti, Sudani, Arabia Saudite, Jemeni..., duhet të llogarisë në një agresion ushtarak, të miratuar ose jo nga ana e Kombeve të Bashkuara.



### *Përfundim*

Edhe pse nuk mundemi që të gjitha qëndrimet e lartpërmendura të antiglobalistëve të hudhen poshtë si të pabaza dhe të pavërteta, që të vlersojmë se a është procesi i globalizimit në dëm apo në dobi të njeriut, ose a është proces pozitiv apo negativ në përgjithsi, mendoj se duhet përveç anëve negative të analizohen edhe anët pozitive të tij.

Sa për fund, do të kisha theksuar se, me sa duket dhe me sa shohim dëmi i këtij procesi të quajtur globalizëm është kah rëndon, por shpresojmë që ky proces do të marrë të mbarën drejt dobisë njerëzore.

Globalizmi që po ndodh sot nuk është aspak në interes të njerëzve, por të korporatave të fuqishme. Globalizmi që po ndodh sot në botë është një lloj mënyre për të shfrytëzuar krahun e lirë të punës në vendet më pak të zhvilluara.

Për sa kohë kjo vazhdon, edhe levizja e jo-globalëve do të vazhdojë.

*Literatura e shfrytëzuar*

1. Prof.Dr. Etem Aziri - "Sociologjia", Tetovë - 2007
2. Dr. Ali Pajaziti - Fjalor
3. Mr. Rejhan Neziri - "Globalizimi", Marë nga: [www.el-hikmeh.net](http://www.el-hikmeh.net), parë për herë të fundit më datë 17 Nëntor 2008.
4. Mr. Qani Nesimi - "Globalizmi - në dobi apo në dëm të njeriut", Marë nga: <http://www.zeriislam.com/2008/Globalizmi-ne-dobi-apo-ne-dem-te-njeriut.html>, parë për herë të fundit më datë 12 Prill 2009.
5. Jakub Patocka - "Globalizacijata Ne e Dožd", marë nga: [www.eurozine.com](http://www.eurozine.com), parë për herë të fundit më datë 30 Nëntor 2008.
6. Enri Hide - "Globalizmi dhe anti-globalizmi", Marrë nga [www.forumishqiptar.com/archire/index.php/html](http://www.forumishqiptar.com/archire/index.php/html) - parë për herë të fundit më datë 30 Mars 2009.
7. Ten Ways to Democratize the Global Economy - [www.globalexchange.org/economy/rulemakers/TenWaysToDemocratize.html](http://www.globalexchange.org/economy/rulemakers/TenWaysToDemocratize.html), parë për herë të fundit më datë 10 Prill 2009.
8. Žan-Fransoa Revel - "Antiglobalizam = Antiamerikanizam", Marë nga: [http://www.katalaksija.com/v2.0/index.php?option=com\\_content&task=view&id=28&Itemid=4](http://www.katalaksija.com/v2.0/index.php?option=com_content&task=view&id=28&Itemid=4), parë për herë të fundit më datë 12 Prill 2009.
9. [http://en.wikipedia.org/wiki/Anti-globalization\\_movement](http://en.wikipedia.org/wiki/Anti-globalization_movement)
10. <http://www.ifg.org/index.htm>